ONE ALBANIA SHA

Rr: "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square21" Tiranë, Shqipëri

# Përmbledhje e kontratës

- Kjo përmbledhje e kontratës përmban elementët kryesorë të kësaj oferte të shërbimit sipas kërkesave të Ligjit 54/2024[1]
- Ky informacion lehtëson krahasimin midis ofertave të shërbimit.
- Informacion i plotë për shërbimin jepet në dokumenta të tjerë.

**Shërbimi/shërbimet dhe pajisje fundore**

**Sherbim internet nepermjet Paketes HomeNet**
Pajisjet fundore i jepen Pajtimtarit ne perdorim.

**Çmimi**

**Volumi internet dhe mjetet juridike të ankimit/zgjidhjes së mosmarrëveshjeve**

Ankesat mund të paraqiten: nëpërmjet numrave 142 dhe 123 për të gjitha llojet e ankesave, nëpërmjet sporteleve të One Albania ku merret deklarim shkresor për ankesën, nëpërmjet postës drejtuar në adresën zyrtare të One Albania, për të gjitha llojet e ankesave me email në adresën ankesa-zyrtare@one.al në përputhje me Udhëzuesin për Zgjidhjen e Ankesave, publikuar në web *https://www.one.al/sites/default/documents/files/inline-files/Aneksi%20nr.2%20Udhezues%20per%20zgjidhjen%20e%20ankesave_1.pdf*

| Plani | Shpejtësia maksimale e Internetit<br>Shkarkim/Ngarkim<br>Deri në: | Volumi Internet<br>GB | Pajtimi Mujor<br>Lekë me TVSH<br>12M | 24M |
|---|---|---|---|---|
| HomeNet 5G | 2Gbps/150 Mbps | 1034 | 1,940 | 1,630 |
| HomeNet Mix 5G | 2Gbps/150 Mbps | 1034 | | 1,630 |
| One HomeNet Mix | 300 Mbps/50 Mbps | 510 | | 1,320 |
| HomeNet Advance | 300 Mbps/50 Mbps | 510 | 1,320 | 1,320 |
| One HomeNet_Student | 300 Mbps/50 Mbps | 510 | 1,020 | 1,020 |

Planet HomeNet Mix ofrohen me zbritje 300 lekë në pajtim mujor për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

**Kohëzgjatja, rinovimi dhe përfundimi**

- Kohezgjatja e afatit fillestar minimal eshte 12 muaj ose 24 Muaj. Planet HomeNet Mix ofrohen me afat fillestar minimal 24 Muaj.
- Në cdo kohë pas afatit fillestar minimal 12/24 muaj pajtimtari mund të rinovojë kontratën.
- Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse per të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- Në cdo rast perfundimi te kontrates se pajtimit pajisjet fundore HomeNet duhet te kthehen në kuti së bashku me të gjithë aksesorët. Ne rast mosdorezimi ose kur konstatohet prej ONE se pajisjet e dhëna në përdorim pajtimtarit janë dëmtuar prej tij, atëherë Pajtimtari detyrohet t'i paguajë ONE-it si penalitet vlerën prej 6,000 lekë, krahas detyrimeve të tjera monetare që rrjedhin prej kontratës së pajtimit të lidhur midis palëve.

**Informacione të tjera të rëndësishme**

- Me lidhjen e kontratës së pajtimit, Pajtimtari do të paguajë një shumë prej 300 lekë si tarifë aktivizimi të kontratës si dhe 1500 lekë, që do të shërbejë si garanci gjatë përdorimit të pajisjes prej tij
- Njësitë GB te mësipërme nuk janë të vlefshme për t'u përdorur në Roaming.
- Përllogaritja e konsumit të internetit do të bëhet cdo 100 KB.
- Pas konsumimit të GB të përfshira në paketë, klientët do te vazhdojnë lundrimin në internet por me shpejtësi të kufizuar (deri në 256 kbps)
- Maksimumi i zonave të lejuara për HomeNet është 5 zona. Aktivizimi i 2 zonave të para është falas, 3 zonat shtesë janë me një pagesë prej 300 lekë/zone.
- Planet HomeNet Mix dhe HomeNet Mix 5G ofrohen vetëm nëse Pajtimtari ka ose aktivizon një numër me paspagesë.

Ky Dokument është publikuar në datë 1 Maj 2026

1 Pika 5 e Nenit 141 të Ligjit 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", e cila është përafruar plotësisht me Nenin 102 (3) të Direktivës (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, që përcakton Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike (OJ L 321, 17.12.2018, f. 36)